

KUD 347.65

TRASHEGIMI ME TESTAMENT

Msc.Majlinda Belegu
majlinda_belegu@hotmail.com

Abstrakt

E Drejta Romake kishte një thënjë “Nuk është mirë të vdiset pa testament” një çështje shumë interesante dhe e rëndësishme. Qysh nga Kodi Civil i Francës i cili njihet si Kushtetuta e Drejtës Civile por, edhe te gjitha kodet tjera civile, është përfshirë trashëgimi ligjor dhe testamentar. Edhe Kodi Civil i Ahmet Zogut ka një libër të ve/antë për trashëgimin. Ligji mbi Trashëgiminë i Republikës së Kosovës e ka përfshirë trashëgimin me testament si një dukuri tejet të rëndësishme duke i dhënë prioritet këtyre normave. Kur trashëgimlënësi vdes, hapet trashëgimia ku të gjithë trashëgimtarët e domosdoshëm trashëgojnë në përqindje të barabartë, por, çështja nuk qëndron kështu, kur de kujusi ka shkruar testament dhe e ka potencuar se kush do të jetë trashëgimtar i tij. Nga vizitat e mia në gjykatë kam ardh në përfundim se shumica e çështjeve të trashëgimit, pra, pasuria e de kujusit, bartet te trashëgimtarët si trashëgim ligjor, mbahet seance gjyqësore duke trashëguar pasurinë secili anëtarë i rendeve të trashëgimit. Të rralla janë rastet kur hapet testamenti dhe i caktohet secilit pasuria që do të trashëgojnë. Në të ardhmen testamenti shpresoj se do të jete i pranishëm edhe tek popullata ashtu si edhe është përfshirë në legjislacion.

Fjalet kyçe: E Drejta, Ligji, Testamenti, Trashegimlëneshi, Trashegimtari, Pasuria, Ligji për Trashegimine, Kodi Civil.

Hyrje

Qysh nga e Drejta Romake është parim dhe është thënë se ” ***nuk është mirë të vdiset pa testament***”.

E drejta e trashëgimisë si degë e së drejtës civile është degë shumë e vjetër që nga koha romake, por ajo ka evoluuar që nga ajo kohë e deri me sot.

E drejta jonë pozitive si bazë për thirrje në trashëgimi e parasheh trashëgimin ligjor dhe atë testamentar. Prioritet sipas së drejtës sonë ka trashëgimi me testament. Ligji jonë i cili është në fuqi përjashton edhe trashëgiminë me kontratë të cilën e parashohin pothuajse të gjitha legjislacionet evropiane.

=====

Në punimin tim kam kontribuar sadopak për institutin e trashëgimisë me testament e cila është shumë më e rrallë se trashëgimia ligjore.

Objekti kryesor i këtij punimi është trashëgimi me testament në territorin e Kosovës si njëra nga dy bazat e thirrjes në trashëgimi.

Arsyeja kryesore e trajtimit të kësaj teme, në radhë të parë është studimi analitik i çështjes së trashëgimit me testament, si dukuri e shpeshtë në botën bashkëkohore e në veçanti në Kosovë është e rregulluar me ligjin për trashëgiminë. Por për të pasur një pasqyrë më komplete në shtruarjen e kësaj teme, kam menduar të jepet edhe një vështrim, mbi testamentin në përgjithësi e sidomos për llojet e testamentit në vendin tonë, si dhe të gjitha kushtet që nevojiten që nga përpilimi i testamentit e deri te hapja, interpretimi i tij si dhe ekzekutimi i tij.

Mendoj se në literaturën tonë juridike në Kosovë kanë munguar studimet shkencore në këtë lëmi. Pikërisht për këtë çështje, konsideroj se studimi i një teme të tillë është në dobi dhe interes shoqëror si për juristët ashtu edhe për të gjithë shkencën shqiptare në përgjithësi.

Sipas statistikave të gjykatave shumica e personave të vdekurin pa lënë testament, edhe ato pak testamente gjyqësore janë ende të pahapura sepse shumica prej trashëgimlënësve janë ende gjallë.

Pra, trashëgimia bartet përmes ligjit vetëm në rastet kur nuk ka testament, atëherë, me anë të kësaj vijnë në përfundim se testamenti në të drejtën tonë gëzon prioritet. Janë rraste më të rralla me anë të të cilave pasuria ndahet me testament.

Është ligj i natyrës se njerëzit lindin, zhvillohen, rriten, krijojnë të mira për jetesë, nga puna gjatë jetës ata krijojnë edhe pasuri, por ata në fund edhe vdesin, prandaj pasuria e tyre do të bartet nga ata tek trashëgimtarët. Unë si studente e masterit e kam parë të udhës dhe shumë të rëndësishme punimin e një punimi seminarik lidhur me trashëgiminë çka do të kontribuoj sadopak në lëmin e drejtës civile e konkretisht në atë trashëgimore.

1. TRASHËGIMI ME TESTAMENT

1. 1. Trashëgimi me testament në Perandorinë Romake

E Drejta Romake i ka kushtuar rëndësi trashëgimisë me testament e cila ishte shprehje e dëshirës së trashëgimlënsit se kujt do ti takojë dhe si ndahet pasuria e tij në rast vdekjeje. Në fakt kjo ishte forma më e zakonshme e fitimit të pasurisë *mortis causa*. Testamenti ishte akt i njëanshëm që realizohej në prani të dëshmitarëve me anë të të cilit pater dispononte pasurinë e tij kur të mos ishte më i gjallë.¹¹¹ Sipas së Drejtës

¹¹¹ Arta Mandro, E Drejta Romake, Tiranë, 2007, fq.434.

=====

Romake testamenti paraqiste këto karakteristika e ndër të cialt testamenti ishte:

- ius civile
- plotësisht personal
- akt formal
- veprim i njëanshmëm
- i revokueshëm¹¹²

Nga kjo shohim se që nga e drejta romake e deri sot në të drejtën bashkëkohore testamenti i përmban të njëjtat karakteristika.

1. 2. Forma e testamentit

Forma më e lashtë e testamentit në Romë ishte *testamentum comitiis*. Këtë testament mund ta përpilonin romakët madhor meshkuj gjithsejt dy herë në vit.

E drejta e lashtë romake njihte edhe testamentin e jashtëzakonshëm të drejtë për përpilimin e këtij testamenti kishin ushatarakët gjatë kohës së ekspeditave ushtarake. Më vonë në periodë klasike u ruajt forma e testamentit dhe si testamenti më i përhapur ishte testamenti pretorian. Me kalimin e kohës e Drejta Romake i njehtë këto lloje të testamenteve e ato janë:

- testamente të rëndomta, dhe
- testamente të jashtëzakonshme.

Testamentet e rëndomta ndaheshin në testamente private dhe publike.¹¹³ Testamentet private ishin ato që kur përpiloheshin nuk merrnin pjesë organet shtetërore, ndërsa publike ishin ato që përpiloheshin në asistimin e nënpunësve shtetëror.

2. Përmabjtja plotëfuqishmëria dhe hapja e testamentit

Përmabjtja themelore e testamentit ishte emërtimi i trashëgimtarit. Emërimi i trashëgimtarit konsiderohet si fillim dhe si bazë e testamentit. Trashëgimtar mund të emëroheshin një ose më shumë persona. Çka është krejt e ngjashme me testamentin e sotëm.

3. Revokimi i testamentit dhe hapja e tij

Testamentin *De cujusi* mund ta revokonte në çdo kohë. Hapja e testamentit ishte akt i rëndësishëm për të gjithë personat që pretendonin të merrnin masën e trashëgimit të *de cujusit*. Ky akt ishte privat dhe zhvillohej

¹¹² Arta Mandro, veper e cituar, fq 435.

¹¹³ Ivo Puhani, "E Drejta Romake", Prishtinë, fq 418.

=====

në praninë e dëshmitarëve gjersa nuk hyri tatimi i trashëgimit dhe gjersa nuk hynë në fuqi ligjet kadukare të Agustinit. Prej asaj kohe në hapjen e testamentit ishin të pranishëm organet shtetërore të cilët lexonin testamentin kurse pas leximit e vulosnon përsëri me vulë shtetërore. Trashëgimia ishte e regulluar edhe me Kodin Civil Francez. Ky kod i njihte dy trajta themelore të trashëgimisë: trashëgimia ligjore dhe trashëgimia testamentare.¹¹⁴

4. Trashëgimi me testamnet sipas KCSH të vitit 1929

Kodi Civil i Shqipërisë i vitit 1929 përmbante dispoziata mbi trashëgiminë ligjore dhe me testament në Librin e dytë e tij.

Kodi Civil Shqiptar e kufizonte rrethin e trashëgimitarëve ligjorë deri në shakllën e 6 të tërthortë. Sipas këtij kodi atin, nënën dhe çdo të paralindur tjetër e trashëgonin fëmijët legjitim ose të të paslindurit e këtyre, pa dallim seksi, edhe sikur të kishin lindur nga martesë të ndryshme.

Në Kodin Civil poashtu përfshihej se: ” Trashëgimia me ligj ka vend vetëm, kur e përsa mungon trashëgimia testamentare”.

Format e zakonshme të testamenteve ishin: Testamenti olograf dhe ai me akt noterial të fshehtë ose të hapur.

Ky kod pranonte sistemin e fitimit të trashëgimit, dmth pasuria trashëgimore u kalonte trashëgimitarëve drejtëpërdrejtë në bazë të ligjit ose të testamentit, pa qenë e nevojshme që ata të shprehin pelqimin ose pranimin e tyre.

5. Trashëgimi me testament sipas Ligjit për Trashëgiminë

Sipas ligjit pozitiv ekzistojnë dy baza: Testamenti dhe ligji. Sipas kësaj kemi trashëgimin testamentale dhe ligjore. Trashëgimi ligjor na paraqitet kur trashëgimlësi ka vdekur pa testament. Ndërsa trashëgimi testamental është kur trashëgimlësi ka vdekur dhe ka lënë testament me çrast pasuria e tij ndahet sipas dispozitave të përfshira në testament.

6. Kuptimi i testamentit

Testamenti është disponim për rastin e vdekjes. Testamenti është veprim juridik i njëanshëm rigorozisht personal dhe i revokueshëm.¹¹⁵

Kuptimin e testamentit e ka dhënë vet ligji : Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anën e të cilit ky, disponon pasurinë për kohën e vdekjes.

¹¹⁴ Hilmi Ismajl; Fatmir Sejdiu, “Historia e Shtetit dhe së Drjetës”, Prishtinë , 2000.

¹¹⁵ Andrija Gams, “Hyrje në të Drejtën Civile”, Prishtinë, 1986 fq 370.

=====

Testament do të thotë shprehje e vullnetit të fundit e dhënë në formën e paraparë me ligj, me të cilin trashëgimlënësi (testatori) urdhëron si të veprohet me pasurinë e tij pas vdekjes së tij¹¹⁶.

7. Testamenti është një veprim i njëanshëm

I kryer nga vet trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes.¹¹⁷

Veçoritë kryesore të testamentit janë:

- Akt i njëanshëm juridik
- I revokueshëm
- Rigorozisht personal
- Forma e përcaktuar me ligj

Me shturjen e shoqërisë fisnore dhe të familjeve të mëdha, si dhe të pronësisë kolektive, me forcimin e familjeve të vogla, dhe me çlirimin e pronësisë private nga një varg kufizimesh nën ndikimin direkt të kishës katolike nis të aplikohet në raste të rralla e për interes të saj edhe testamenti institucional¹¹⁸.

E drejta romake i ka kushtuar rëndësi trashëgimisë mirëpo që nga ajo kohë ekzistojnë definicione të cilat përdoren edhe sot e kësaj dite.

Testamenti është urdhër i vullnetit të fundit të trashëgimlënësit. Fjalën urdhër e cila paraqitet shpesh ose në literaturën që i kushtohet të së drejtës testamentare nuk duhet kuptuar si një lloj imponimi në kuptimin ekstrem të shprehjes së autonomisë së vullnetit të trashëgimlënësit, por ky vullnet i shprehur duhet të jetë gjithmonë në pajtim me të drejtën ku ai do të prodhojë efektet e veta.

Trashëgimi me testament sot është mjaft i përhapur nga vet fakti se trashëgimi ligjor zbatohet vetëm në rastet kur mungon testamenti, ose kur testamenti është pjesërisht ose tërësisht i pavlefshëm.

Testatori mund të lërë shumë testamente por sa i përket disponimit të pasurisë apo të një pjese të saj. Testamenti duhet të përmbajë dëshirën e fundit të trashëgimlënësit lidhur me pasurinë e tij.

8. Përmbajtja e testamentit

Dispozitat e testamentit çartë i përmbajnë rregullat të cilat duhet ti përmbajë një testament. Testamenti përbëhet nga:

¹¹⁶ Ligji për Trashëgiminë , i Kosovës, (Ligji 2004/ 26, hyri në fuqi me datë 24 korrik 2004) neni 69 paragrafi 1.

¹¹⁷ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 372.

¹¹⁸ Hamdi Podvorica, “ E Drejta Trashëgimore”, Prihstinë, 2010, faqe 100.

- Caktimi i trashëgimtarëve si dhe caktimi i personave të cilët përjashtohen nga trashëgimia
- Përcaktimi i pasurisë që do ti kalojë trashëgimtarit
- Detyrimet që u caktohen trashëgimtarëve dhe personave të tjerë testamentar ose ligjor.

9. Caktimi i zbatuesit të testamentit

Qysh nga e drejta romake përmbajtja themelore e testamentit është caktimi i trashëgimtarit.

Sipas Ligjit për Trashëgimi, i Kosovës parashihet që trashëgimlënësi me testament ta përfshijë një ose më shumë trashëgimtarë.

Dispozitat të cilat i përmban testamenti janë të shumëllojshme, por sipas teorisë juridike ato mund të ndahen kryesisht në dispozita materiale dhe formale. Njëherësh vlen të thuhet se testamenti përmban edhe dispozita tjera për çështjet si falja e padenjësisë, borxhi etj.

Dispozitat e testamentit ndahen në: dispozita pasurore dhe dispozita jopasurore.¹¹⁹

Përmbajtja formale e testamentit ka të bëjë me rastin e caktimit të ndonjë ekzekutori të testamentit apo caktimin e të ashtuquajturit konkretizator të vullnetit të testatorit vetëm në lidhje me një normë të veçantë në testament.¹²⁰ Në testament mund të emërohet dhe zëvendësi i trashëgimtarit e këtë e bënë testatori.

10. Kushtet e përgjithshme për vlefshmërinë e testamentit

Kushtet e përgjithshme për vlefshmërinë e testamentit i ka paraparë edhe Ligji për Trashëgiminë i Kosovës.

- Zotësia për të përpiluar testament
- Pavlefshmëria e testamentit për shkak të të metave në vullnetin e trashëgimlënësit
- Nulimi i testamentit për shkak të paaftësisë së trashëgimlënësit dhe për shkak të të metave në vullnetin e tij

Testament mund të bëjë çdo person që ka zotësi për të vepruar dhe i cili i ka mbushur 18 vjet¹²¹.

Testament mund të bëjë edhe personi që ka zotësi për të vepruar e i ka mbushur 16 vjet dhe është i martuar.

¹¹⁹ Hamdi Podvorica, veper e cituar, fq 103.

¹²⁰ Po aty, fq 103.

¹²¹ Ligji për Trashëgiminë, i Kosovës, neni 70 pargarfi 1.

=====

Nëse testatori e humb zotësinë për të vepruar pas përpilimit të testamentit testamenti është i vlefshëm. Zotësia e veprimit hiqet me vendim të gjykatës andaj personi të cilit i është hequr zotësia e veprimit dhe nuk e kupton rëndësinë e testamentit nuk mund të përpilojë testament.

Sipas nenit 71 paragrafi 1 i pavlefshëm llogaritet të jetë edhe ai testament i cili është përpiluar nga testatori i cili ka qenë i shtyrë në përpilimin e tij me anë të kanosjes dhunës mashtrimit dhe lajthimit. Ka raste kur testamenti është përpiluar vetëm në disa pjesë me anë të kanosjes shtrëngimit dhe mashtrimit atëherë vetëm këto pjesë shpallen të pavlefshme ndërkaj pjesa tjetër e testamentit mbetet në fuqi.

Procedurën për anulimin e testamentit për shkak se ai është përpiluar nën ndikimin e dhunës kanosjes dhe mashtrimit, mund ta kërkojë personi i cili ka interes juridik, afati subjektiv është 1 vjeçar ndërkaj afati objektiv 10 vjet nga shpallja e testamentit.

11. Karakteristikat e Testamentit

11.1 Testamenti si akt rigoroz personal

Testamenti është akt rigoroz personal, për këtë arsye përcaktohet që vullnetin e fundit ta shprehë personalisht testatori në mënyrën e përcaktuar me norma ligjore madje pavarësisht se për çfarë lloji të tij është fjala, që testamenti të jetë i plotëfuqishëm. Me rastin e përpilimit të testamentit përjashtohet çdo mundësi e përfaqësimit.

11.2 Testamenti është punë juridike mortis causa

Testamenti është punë juridike që prodhon efekte vetëm në çastin e vdekjes së trashëgimlënës, kur pasuria trashëgimore me forcën e ligjit kalon në trashëgimtarë.

Gjithnjë sa është gjallë trashëgimlënsi trashëgimtari nuk mund të trashëgojë pasurinë trashëgimore të caktuar me testament dhe nuk mund të ketë kurrfarë dobie për trashëgimtarë. Për këtë arsye efekti i testamentit është i lidhur drejtëpërdrejtë me faktin e vdekjes së trashëgimlënsit, andaj quhet punë juridike për shkak të vdekje.

11.3. Testamenti është punë juridike bamirëse

Testamenti është punë juridike bamirëse pa kundërshtpërblim. Edhe në rastet kur në testament trashëgimtarët ngarkohen me borxhe, me barrë testamenti gjithmonë ka karakter bamirës.

11.4. Testamenti është punë juridike e njëanshme

Testamenti është akt juridik i njëanshëm ngase lind dhe prodhon efekte juridike vetëm me deklarimin e një vullneti të fundit. Vullneti i fundit i formuluar në testament duhet të jetë vullnet i vërtetë real, i shfaqur lirisht nga trashëgimlënsi pa kurrfarë shtrëngimesh. Në rastet kur ekziston vullneti me të meta i trashëgimlënsit atëherë shakaktohet pavlefshëmira e testamentit.

Testamenti mund të jetë tërësisht apo pjesërisht i pavlefshëm. Testamenti është tërësisht i pavlefshëm kur të gjitha dispozitat e tij janë bërë me kanosje, dhunë, mashtrim, shtrëngim ose me lajthitje. Ndërkaq testamenti është pjesërisht i pavlefshëm kur vetëm një pjesë e dispozitave të tij është bërë me anë të kanosjes shtrëngimit mashtrimi; ndërsa pjesa tjetër e dispozitave mbetet në fuqi, sepse në këtë pjesë nuk ka të meta në vullnetin e lirë të shprehur të fundit të trashëgimlënsit.

11.5. Testamenti si akt formal

Testamenti është akt formal forma e tij është e përcaktuar rigorozisht me norma ligjore. Në bazë të këtij fakti mund të konstatojmë se testamenti bën pjesë në punët juridike formale, për vlefshmërinë e të cilave kërkohet forma e paraparë me ligj *forma solemnitatim*. Siç dihet testamentet janë të llojeve të ndryshme. I vlefshëm është testamenti i bërë në formën e paraparë me dispozita ligjore dhe në bazë të kushteve të përcaktuara me dispozitat ligjore.¹²²

11.6. Testamenti akt i revokueshëm

Testamenti është akt juridik i revokueshëm pasi testamenti varet nga liria e vullnetit të trashëgimlënsit. Trashëgimlënësi mund të revokojë kurdoherë testamentin në tërësi ose pjesërisht në njërin nga format e parapara me ligj për përpilimin e testamentit.¹²³ Trashëgimlënsi mund ta revokojë testamentin e vet në mënyrë të prerë, me testament të ri (i cili duhet të ketë formën e njetjtë me testamentin e mëparshëm) ose me përpilimin e testamentit të ri, dispozitat e të cilit janë në kundërshtim me testamentin e mëparshëm, kështu që mund të vlejë edhe testamenti i mëparshëm në qoftë se nuk është në kundërshtim me të riun, apo me zhdukjen e thjeshtë të testamentit të mëparshëm.¹²⁴

¹²² Hamdi Podvorica, veper e cituar, fq 107.

¹²³ Ligji për Trashëgiminë, i Kosovës, neni 107 paragrafi 1

¹²⁴ Andrija Gams, "Hyrje në të Drejtën Civile", Prishtinë, 1986 fq 370.

=====

Testamenti me një datë të mëvonshme lë pa fuqi me datë të mëparshme në tërësi apo vetëm në pjesën që nuk pajtohet me testamentin e ri.¹²⁵

12. Me testament ndahet pasuria

Testamenti është akt juridik me të cilin ndahet pasuria trashëgimore. Me testament trashëgimtarët marrin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që trashëgimlënsi i kishte në çastin e vdekjes së tij në mënyrën dhe kushtet e parapara me ligj.

13. Zotësia për të lënë testament

Munden me disponue me testament gjithë ata, që nuk janë dekalruar prej ligjit pazotë.¹²⁶

- Testament mund të bëjë çdo person që ka zotësi për të vepruar dhe i cili i ka mbushur 18 vjet.
- Testament mund të bëjë edhe personi që ka zotësi për të vepruar e i ka mbushur 16 vjet dhe është i martuar.

Zotësia për të vepruar e testatorit duhet të ekzistojë në momentin e përpilimit të testamentit. Një person që në kohën e përpilimit të testamentit nuk është në gjendje për të kuptuar rëndësinë e veprimeve të veta nuk ka zotësi për të përpiluar testament. Personi të cilit me vendim gjyqi i është hequr zotësia për të vepruar, si dhe ai që në kohën e përpilimit (bërjes) së testamentit nuk është në gjendje të kuptojë rëndësinë e veprimit të tij, nuk mund të bëjë testament.

14. Pavlefshmëria e testamentit

Tri janë shkaqet kryesore që si pasojë kanë pavlefshmërinë e testamentit:

- a) Kanosja, shtrëngimi mashtrimi lajthitja
- b) Mungesa e formës së kërkuar me ligj
- c) Mungesa e lirise së vullnetit të tastatorit

¹²⁵ Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, neni 402 pragrafi 1.

¹²⁶ Kodi Civil Shqipërisë, i vitit 1979, neni 205.

14. 1 Vëllimi i pavlefshmërisë së testamentit

Një testament mund të jetë tërësisht i pavlefshëm ose vetëm në një pjesë të tij. A do të jetë testamenti tërësisht i pavlefshëm ose vetëm një pjesë e tij do të varet në radhë të parë nga shkaku i pavlefshmërisë, a ka të bëjë ai me tërë testamentin apo vetëm të një pjese të tij.¹²⁷

14. 2. Testamenti absolut nul

Doktrina juridike konsideron se testamenti është absolut nul nëse dispozitatat e tij janë në kundërshtim me dispozitatat imperative ligjore, me rendin juridik dhe me rregullat e moralit, pra, shkelet interesi shoqëror. Gjykata ex officio e ka për detyrë për shkaqet absolute të nulitetit absolut. Sipas doktrinë juridike në rast të ekzistimit të kanosjes, shtrëngimit, lajthimit, mashtrimit me rastin e përpilimit të testamentit atëherë testamenti anulohet nga ana e gjykatës.

14. 3. Testamenti relativ nul

Testamenti është relatisvisht nul kur shkaqet e nulitetit cenojnë vetëm interesin personal të një individi të caktuar. Për shkaqet e nuliteti relativ gjykata nuk kujdeset ex officio por personat të cilëve i është cenuar e drejta mund të kërkojnë vetë nulitetin e testamentit.

15. Rruajtja e testamentit

Testamenti rruhet atëherë kur rruhen shkresat që përbëjnë përmbajtjen e testamentit. Qëllimi kryesor i rruajtjes së testamentit është që shkresat të rruhen të padëmtuara. Rruajtja dhe dorëzimi i testamentit janë të rregulluara me dispozita ligjore. Testamentin mund ta rruaj vet testatori tek çdo person fizik dhe juridik, tek avokati, ekzekutori etj. Sipas shkencës juridike rruajtja e testamentit bëhet në këto mënyra:

- a. rruajtja e testamentit nga vet testatori,
- b. rruajtja e testamentit nga personi i besuar i testatorit
- c. rruajtja e testamentit nga institucionet si banka posta etj

¹²⁷ Hamdi Podvorica, veper e cituar, fq 114.

16. Interpretimi i testamentit

Interpretimi i testamentit është rregulluar me LTK me nenin 91 të këtij ligji. Dispozitat e testamentit interpretohen sipas qëllimit të vërtetë të testatorit.¹²⁸

Interpretimi i testamentit nënkupton gjetjen e qëllimit të vërtetë të testatorit të manifestuar në deklaratën e vullnetit të fundit. Interpretimi mund të bëhet në mënyra të ndryshme si ai gjuhësor, logjik etj.

17. Llojet e testamentit

Testamentet i ndajmë sipas formës në të cilën përpilohen testamenetet. Ato ndahen në:

- të rregullta dhe të jashtëzakonshme, si dhe
- private dhe publike.

Testamentet e rregullta janë ato që mund të përpilohen në çdo rast.

Testamentet e jashtëzakonshme janë ato testamente që përpilohen në rastet e jashtëzakonshme të cilat ligji i parasheh në mënyrë të veçantë, forma e tyre është e thjeshtësuar, por vlejnë vetëm një kohë të caktuar gjersa të vazhdojë rrethana e jashtëzakonshme.¹²⁹ Testamentet e rregullta janë testamentet e shkruara nga vet testatori, testamentet e shkruara para dëshmitarëve, testamentet gjyqësore dhe diplomatike. Ndërsa testamentet e jashtëzakonshme janë testamentet e përpiluara në anije, testamentet ushtarake dhe testamentet verbale.

Llojet e testamenteve në LTK janë të rregulluara me nenet 74, 75 76 dhe 77, e ato janë:

- Testamenti i shkruar nga vetë testatori
- Testamenti me shkrim në praninë e dëshmitarëve
- Testamenti gjyqësor
- Testamenti në rrethana të jashtëzakonshme

Përfundimi

Një nga parimet themelore të rregullimit juridik është liria e disponimit me testament. Kushdo është i lirë që me vullnetin e vet, të shfaqur në formën e testamentit, të caktojë se kush do të trashëgojë dhe caktojë mënyrat e këtij trashëgimi. Testatori bën ndarjen e pasurisë së tij në rast vdekje.

¹²⁸ Ligji për Trashëgiminë, i Kosovës, neni 91 paragrafi 1.

¹²⁹ Andrija Gams, veper e cituar, fq 372.

Gjatë hulumtimit tim dhe analizës së disa statistikave kam hasur në një numër shumë të vogël testamentesh, me një fjalë e gjithë pasuria e trashëgimlënësve ka kaluar tek trashëgimtarët në mënyrë ligjore. Si mënyrë shumë korekte e bartjes së pasurisë legjislacioni ynë shumë mirë e ka potencuar dhe i ka dhënë një rëndësi të madhe kësaj mënyre të trashëgimit.

Me qenë se vendi ynë ka kaluar para një kohe jo shumë të gjatë në një situatë shumë të vështirë, pra ne kemi qenë në luftë para disa viteve, atëherë mendoj se është shumë mirë që legjislacioni ynë ka përfshirë edhe mënyrat e bartjes së trashëgimit në rastet e jashtëzakonshme, pra testamentin në rastet e luftës, testamentin në anije, etj.

Mendoj se vetëm me anë të testamentit dëshira e testatorit për bartjen e pasurisë së tij do të shkojë në vendin e duhur, sepse poqëse ajo do të bartej sipas ligjit ajo nuk do të paraqiste dëshirën e testatorit për pasurinë e tij.

Literatura

A. Libra, Artikuj, Botime

- 1) Gams, Andrija. “Hyrje në të Drejtën Civile”, Prishtinë, 1986
- 2) Gjilani, F. “Historia e Shtetit dhe së Drejtës në Shqipëri” Libri II, kapitulli V “Shteti dhe e Drejta gjatë Regjimit të Ahmet Zogut”, Luarasi, Tiranë, 1997.
- 3) Ismajli, Hilmi; Sejdiu, Fatmir. “Historia e Shtetit dhe së Drejtës”, Prishtinë, 2000.
- 4) Mandro, Arta. “E Drejta Romake”, Tiranë, 2007.
- 5) Podvorica, Hamdi. “E Drejta Trashëgimore”, Prihstinë, 2010.
- 6) Puan, Ivo. “E Drejta Romake”, Prishtinë, 1968.

B. Ligjet

- 1) Ligji për Trashëgiminë, i Kosovës, (Ligji 2004/ 26, hyri në fuqi me datë 24 korrik 2004).
- 2) Kodi Civil i Shqipërisë, i vitit 1994.
- 3) Kodi Civil i Shqipërisë, i vitit 1929.
- 4) Kodi Civil Shqipërisë, i vitit 1979.